



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
MIRATIMIN/LICENCIMIN E PERSONAVE PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË E
AGJENTIT NË SIGURIME, SI DHE RASTET E MOSPRANIMIT TË REGJISTRIMIT
TË TIJ DHE REFUZIMIT TË LICENCËS

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 79, datë 31.08.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215, datë 31.10.2018
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 27, datë 28.02.2022
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 89, datë 28.04.2022
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 25.07.2025

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton:

- a. Kriteret e profesionalizmit, etikës, të besueshmërisë dhe kërkesat financiare që duhet të plotësojë agjenti në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij;
- b. Kërkesat, procedurat dhe afatet e licencimit të shoqërisë së agjentëve si dhe rastet e refuzimit;
- c. Rregulla për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit nga bankat, degët e bankave të huaja, subjektet financiare jo banka dhe subjektet e tjera, si dhe nga dega e shoqërisë së agjentëve të një vendi të huaj;

- d. Shumën e mbulimit të policës së sigurimit të përgjegjësive profesionale të agjentit/shoqërisë së agjentëve ndaj palëve të treta;
- e. Rregulla për kriteret e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë së agjentëve;
- f. Rregulla për transferimin e parave nga konsumatori te shoqëria e sigurimit dhe anasjelltas, me ndërmjetësinë e agjentit në sigurime.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të pikës 2, nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe neneve 194 pika 4, 196 pika 7, 197 pika 3, 198 pika 6, 199 pika 3, 200 pika 4 dhe 201 pika 1, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

KREU II

AGJENTI NË SIGURIME

Neni 3

Kriteret për miratimin e agjentit në sigurime

Personi fizik, i cili kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime, duhet të përmbushë kriteret e profesionalizmit, etikës, të besueshmërisë dhe kërkesat financiare si më poshtë:

- a. Ka përfunduar të paktën studimet e shkollës së mesme;
- b. Ka kryer kualifikim profesional në fushën e sigurimit pranë një instituti apo qendre edukimi, në programe të njohura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- c. Nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale. Ndaj tij nuk ka në proces çështje penale në Prokurori apo Gjykatë;
- d. Nuk ka qenë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- e. Nuk është i punësuar në ndonjë shoqëri sigurimi;
- f. Nuk ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paftësisë paguese ndaj të tretëve;
- g. Nuk ka detyrime të papaguara ndaj organeve tatimore;
- h. Nuk i është ndaluar më parë ushtrimi i veprimtarisë së agjentit në sigurime sipas parashikimeve të nenit 199, si dhe ushtrimi i veprimtarisë së brokerimit sipas nenit 209 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014;
- i. Të ketë një garanci financiare të paktën 300,000 lekë të depozituar në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të shoqërisë së sigurimit për të cilën vepron;
- j. Të disponojë sigurimin e përgjegjësive profesionale ndaj palëve të treta, kundrejt dëmeve të shkaktuara nga kryerja e veprimtarisë së agjentit në një shumë jo më të vogël se

100,000 lekë për çdo ngjarje të siguruar, ose jo më të vogël se 150,000 lekë në vit për të gjitha rastet e sigurimit.

Neni 4

Dokumentacioni për miratimin e agjentit në sigurime

1. Personi fizik, i cili kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime, plotëson kërkesën me shkrim, sipas formë kërkesës të paraqitur në aneksin 1 të kësaj rregullore, të shoqëruar me:
 - a. CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
 - b. Diplomë të shkollës së mesme/të lartë;
 - c. Dokument që vërteton kryerjen e kualifikimit profesional;
 - d. Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore dhe vërtetime nga prokuroria e gjykata se ndaj tij nuk ka në proces çështje penale;
 - e. Deklarata në përmbushje të kërkesave të germës d), e) dhe f), të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - f. Dokument që vërteton se nuk ka detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore;
 - g. Dokument bankar që vërteton zotërimin e garancisë financiare sipas pikës (i) të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - h. Policën e sigurimit për përgjegjësi profesionale;
 - i. Dokument që vërteton pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar për miratimin e agjentit në sigurime depozitohet në Autoritet nga shoqëria e sigurimit në emër dhe për llogari të së cilës do të ushtrojë veprimtarinë agjenti.
3. Përveç dokumentacionit të mësipërm, shoqëria e sigurimit depoziton një kopje të kontratës me aplikantin për kryerjen e veprimtarisë së agjentit, si dhe kopje të noterizuara të kontratës së qerasë, apo të certifikatës së pronësisë të mjedisit ku do të ushtrohet veprimtaria e agjentit.
4. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

KREU III

LICENIMI I SHOQËRISË SË AGJENTËVE NË SIGURIME DHE I DEGËS SË SHOQËRISË SË HUAJ TË AGJENTIT

Neni 5

Kërkesat për licencimin e shoqërisë së agjentëve në sigurime

Personi juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e agjentit në sigurime, përveç kërkesave të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, duhet të plotësojë edhe kërkesat si më poshtë:

- a. Administratori/ët e shoqërisë së agjentëve duhet:
 - i. Të kenë përfunduar studimet universitare;
 - ii. Të kenë përvojë profesionale të paktën dy vjet në fushën e sigurimeve;
 - iii. Të plotësojnë kërkesat e parashikuara në gjerat c), d), e), f) dhe g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
- b. Kur personi juridik është shoqëri aksionare, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit të shoqërisë duhet:
 - i. Të kenë përfunduar studimet universitare;
 - ii. Të plotësojnë kërkesat e parashikuara në gjerat c), d), e), f) dhe g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
- c. Nuk i është revokuar më parë licenca sipas parashikimeve të neneve 201 dhe 211 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014.

Neni 6

Dokumentacioni për licencimin e shoqërisë së agjentëve në sigurime

1. Personi juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë si shoqëri e agjentit në sigurime, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë me shkrim, sipas formë kërkesës të paraqitur në aneksin 2, të kësaj rregullore, të shoqëruar nga:
 - a. Projektstatuti i shoqërisë;
 - b. Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të shoqërisë;
 - c. Të dhëna për ortakët/aksionarët, administratorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit dhe personelin, si dhe personat e ngarkuar nga shoqëria për të kryer veprimtarinë e agjentit për shoqërinë;
 - d. Për administratorin/ët, Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit të shoqërisë së agjentëve dokumentet që vërtetojnë plotësimin e nenit 5 të kësaj rregulloreje;
 - e. Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së agjentit, i cili të përfshijë edhe detaje të zhvillimit të tij dhe projektimet financiare;
 - f. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikën dhe/ose procedurat për:
 - i. Mënyrën e informimit të klientëve dhe trajtimit të ankesave;
 - ii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - iii. Trajtimin e konfliktit të interesit;
 - iv. Funksionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të shoqërisë së agjentëve me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

- g. Adresa/t në të cilin do të ushtrohet veprimtaria e agjentit;
 - h. Dokument që vërteton se shoqëria e agjentëve disponon ambiente dhe infrastrukturë të nevojshme për shitjen e produkteve të sigurimit;
 - i. Dokumenti bankar që vërteton pagimin e kapitalit minimal në para prej 1,000,000 Lekë, në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e R.Sh.;
 - j. Dokumenti që vërteton se ka garanci financiare të paktën 500,000 lekë të depozituar në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të shoqërisë së sigurimit për të cilën vepron;
 - j/1. Dokument bankar që vërteton pagimin në llogari të ndara të garancisë financiare, kur shoqëria e agjentëve do ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime për Jetë dhe Jo-Jetë;
 - k. Kontrata e punësimit me kohë të plotë për të paktën një agjent të miratuar;
 - l. Deklarata për mos qenie palë e lidhur me një shoqëri sigurimi, shoqëri tjetër agjentësh apo shoqëri brokerimi në sigurime dhe risigurime;
 - m. Dokumenti që vërteton pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopje të noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.
 3. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 7

Licencimi si agjent në sigurime i degës së shoqërisë së huaj të agjentit

1. Dega e shoqërisë së huaj të agjentit, e cila kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në Shqipëri duhet të pajiset me licencë nga Autoriteti.
2. Për licencimin e degës së shoqërisë së huaj të agjentit, zbatohet rregullat e përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.
3. Dega e shoqërisë së huaj të agjentit, e cila kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e agjentit në sigurime, përveç dokumentacionit të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje, paraqet edhe:
 - a. Statutin e shoqërisë së huaj, apo aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të vendit të origjinës së shoqërisë së huaj;
 - b. Dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj të agjentit në vendin ku ushtron veprimtari si dhe licencën/miratimin për të kryer aktivitet agjenti në sigurime të lëshuar nga autoriteti përgjegjës;
 - c. Vendimin e organit drejtues të shoqërisë së huaj për shtrirje të veprimtarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe hapjen e degës së shoqërisë së huaj;

- d. Dokumentacionin, që vërteton statusin aktual të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;
 - e. Bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;
 - f. Miratimin zyrtar për hapjen e degës së shoqërisë së huaj dhënë nga autoriteti përgjegjës i vendit ku ndodhet selia qendrore e saj;
 - g. Dokumenti që vërteton pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014.
4. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopje të noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.
 5. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

KREU IV
LICENCIMI I BANKËS/DEGËS SË BANKËS SË HUAJ, SUBJEKTEVE FINANCIARE
JOBANKA, SI DHE SUBJEKTEVE TË TJERA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË
SË AGJENTIT NË SIGURIME

Neni 8

Ushtrimi i veprimtarisë së agjentit në sigurime nga banka/dega e bankës së huaj dhe subjektet financiare jobanka

1. Banka/dega e bankës së huaj dhe subjektet financiare jobanka, të cilat kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e agjentit në sigurime, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, aplikojnë në Autoritet për t'u licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
2. Veprimtaria e agjentit në sigurime nga banka/dega e bankës së huaj/subjekti financiar jobankë ushtrohet nëpërmjet agjentit të miratuar nga Autoriteti.

Neni 9

Dokumentacioni për licencimin e bankës/degës së bankës së huaj dhe subjekteve financiare jobanka për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime

1. Kërkesa me shkrim, sipas formë kërkesës në aneksin 3 të kësaj rregulloreje, e paraqitur nga banka/dega e bankës së huaj apo subjekti financiar jobankë, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, shoqërohet me:
 - a. Vendimin e miratimit nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari agjenti në sigurime;
 - b. Të dhëna për strukturën/njësine që do kryejë veprimtarinë e agjentit;
 - c. Listën e agjentëve të punësuar dhe dokumentacion përkatës të tyre në përmbushje të kërkesave të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - d. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikatat dhe/ose procedurat për:
 - i. Mënyrën e informimit të klientëve dhe trajtimit të ankesave;
 - ii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - e. Kopje e marrëveshjes së bankës/degës së bankës së huaj apo subjektit financiar jobankë me shoqërinë e sigurimit, në emër dhe për llogari të së cilës do të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime;
 - f. Dokumentin që vërteton pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014.

- 1.1 Në rast se subjekti kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime Jetë dhe Jo-Jetë, ose kur është miratuar për ushtrim veprimtari sigurimi të Jetës dhe kërkon edhe për Jo-Jetë ose anasjelltas, duhet që veprimtaritë të jenë të ndara veçmas. Kërkesa me shkrim, sipas formë kërkesës në aneksin 3, të kësaj rregulloreje, shoqërohet me:
 - a. Vendimin e miratimit nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari agjenti në sigurime (Jetë dhe Jo-Jetë);
 - b. Të dhëna për strukturat/njësitet, organigramat, që do kryejë veprimtarinë e agjentit në sigurime veçmas për Jetë dhe Jo-Jetë, si edhe rregulla për organizimin dhe funksionimin e secilës strukturë;
 - c. Rregullat për raportimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime të jenë veçmas për Jetë dhe Jo-Jetë;
 - d. Lista e agjentëve të punësuar dhe dokumentacioni përkatës i tyre në përmbushje të kërkesave të nenit 3 të kësaj rregulloreje, të jenë veçmas për Jetë dhe Jo-Jetë;
 - e. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikatat dhe/ose procedurat për:
 - i. Mënyrën e informimit të klientëve dhe trajtimit të ankesave veçmas për Jetë dhe Jo-Jetë;
 - ii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, kur kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime të Jetës.
 - f. Kopje të marrëveshjeve me shoqëritë e sigurimit, në emër dhe për llogari të të cilave do të ushtrojnë veprimtarinë e agjentit në sigurime të Jetës dhe Jo-Jetës;
 - g. Dokumentet që vërtetojnë pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014, e ndryshuar.

2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopje të noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.
3. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 10

Ushtrimi i veprimtarisë së agjentit në sigurime nga subjekte të tjera

1. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe nga subjekte të tjera tregtare në rastet, kur shitja e produkteve të sigurimit nga këto subjekte, përputhet apo plotëson veprimtarinë parësore tregtare të tyre. Në kuptim të kësaj pike, subjekte të tjera që mund të ushtrojnë veprimtarinë e agjentit janë ato që ofrojnë shërbimin postar, shërbime financiare, shërbime si agjenci udhëtimi, si agjenci imobiliare, shërbime të tregtimit të mjeteve motorike.
2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të ushtrojnë veprimtari agjenti në sigurime pasi të jenë pajisur me licencë nga Autoriteti.
3. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të kenë, në mënyrë të vazhdueshme, një garanci financiare në masën 4 për qind të shumës së primeve vjetore të mbledhura, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 500,000 lekë. Garancia financiare depozitohet në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të shoqërisë/shoqërive të sigurimit për të cilën subjektet veprojnë.
4. Veprimtaria e agjentit në sigurime nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ushtrohet nëpërmjet agjentit të miratuar nga Autoriteti.
5. Kërkesa për licencim, sipas formë kërkesës në aneksin 4 të kësaj rregulloreje, depozitohet në Autoritet e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Ekstrakt të regjistrimit të shoqërisë në QKR;
 - b. Vendim të organit vendimmarrës së shoqërisë për shtimin e objektit të veprimtarisë si agjent në sigurime;
 - c. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikat dhe/ose procedurat për:
 - i. Mënyrën e informimit të klientëve dhe trajtimit të ankesave;
 - ii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - d. Adresa(t) në të cilin do të ushtrojë veprimtarinë e agjentit;
 - e. Dokument që vërteton disponimin e ambienteve dhe infrastrukturës së nevojshme për shitjen e produkteve të sigurimit;
 - f. Kontrata e punësimit me kohë të plotë për të paktën një agjent të miratuar;

- g. Marrëveshje e subjektit me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të së cilës do të kryejë veprimtarinë e agjentit në sigurime;
- h. Deklarata për mos qenie palë e lidhur me një shoqëri sigurimi, shoqëri tjetër agentësh apo shoqëri brokerimi në sigurime dhe risigurime;
- i. Dokumenti që vërteton se ka garanci financiare të paktën 500,000 Lekë të depozituar në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të shoqërisë së sigurimit për të cilën vepron;
- j. Dokumenti që vërteton pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014.

Neni 11

Kërkesa mbi mjedisin e ushtrimit të veprimtarisë së agjentit

1. Personi fizik dhe juridik ushtron veprimtarinë e agjentit në një mjedis të përshtatshëm pune.
2. Mjedisi, ku do të ushtrohet veprimtaria e agjentit, duhet të plotësojë të paktën këto kërkesa.
 - i. Të ketë hapësira të nevojshme dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit, vlerave monetare, pajisjeve të punës dhe komunikimit me klientët. Hapësira e punës duhet të jetë jo më pak se 10 m²;
 - ii. Të ketë pajisjet e nevojshme tekniko-administrative, si kompjuter, printer dhe/ose aksesorët e tyre, mjete komunikimi (telefon dhe/ose faks, e-mail), tabelë ku të afishohen të dhënat mbi agjentin, miratimin e tij nga AMF dhe komisioneve sipas produkteve të sigurimit.
3. Shfuqizuar.

Neni 12

Ruajtja e kërkesave të licencimit dhe miratimi i ndryshimeve

1. Kërkesat për miratimin/licencimin e subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që miratimi/licencat janë të vlefshme. Monitorimi i përmbushjes së kërkesave bëhet nga Autoriteti offsite një herë në vit dhe nëpërmjet inspektimeve në vend kur e gjykon të arsyeshme.
2. Agjenti, person fizik, duhet që çdo 3 vjet të kryejë kualifikime profesionale dhe të paraqesë dokumentin përkatës në AMF.

3. Subjektet e përcaktuara në këtë rregullore njoftojnë me shkrim Autoritetin për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është dhënë miratimi/licenca. Çdo ndryshim miratohet nga Autoriteti.

KREU V

PROCEDURAT E MIRATIMIT/LICENCIMIT

Neni 13

Procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit dhe afatet e miratimit/licencimit

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi për miratim/licencim për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime në përputhje me kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 dhe në këtë rregullore.
2. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gjykon të nevojshme, njofton kërkuesin për miratim/licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.
- 2/1. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personit juridik, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.
3. Autoriteti, brenda 1 muaji nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuesit për miratim/licencim, jep ose refuzon miratimin/licencën për ushtrim veprimtarie agjenti në sigurime.
4. Miratimi/licencimi i subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore për ushtrim veprimtarie agjenti në sigurime bëhet për një periudhë pa afat dhe shoqërohet me pagesën e tarifës për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 14

Licenca/Vërtetimi

1. Personi juridik pajiset me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit. Kjo licencë është:
 - a. E patransferueshme dhe e patregtueshme;
 - b. E përcaktuar sipas klasave të sigurimit;
 - c. E përcaktuar në emër dhe për llogari të shoqërisë/ve të sigurimit.

2. Licenca përgatitet në dy kopje, në gjuhën shqipe. Një kopje i jepet të licencuarit dhe një kopje arkivohet në AMF.
3. Agjenti fizik pajiset me vërtetim.
4. Formati i licencës/vërtetimit për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit paraqitet në aneksin 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Rastet e mospranimit të miratimit/refuzimit të licencimit

1. Autoriteti refuzon kërkesën për miratimin/pajisje me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në rastet kur:
 - a. Për degën e shoqërisë së huaj të agjentit nuk përmbushen kërkesat e Ligjit nr. 52, dt. 22.05.2014 dhe të nenit 7 të kësaj rregulloreje;
 - b. Për bankën/degën e bankës së huaj dhe subjektet financiare jobanka, nuk përmbushen kërkesat e Ligjit nr. 52, dt. 22.05.2014, dhe të neneve 8, dhe 9, të kësaj rregulloreje;
 - c. Për subjektet e tjera, nuk përmbushen kërkesat e Ligjit nr. 52, dt. 22.05.2014 dhe të nenit 10, të kësaj rregulloreje.
2. Ka kryer shkelje të legjislacionit të zbatueshëm në fushën e sigurimeve.
3. Vendimi i mospranimit të miratimit/refuzimit të licencimit i bëhet i ditur me shkrim kërkuarit, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tij.

Neni 16

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe garancia financiare

1. Personat juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e agjentit në sigurime, pas miratimit/licencimit nga Autoriteti, por para regjistrimit në QKR, ose para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, duhet të disponojnë:
 - a. Sigurimin e përgjegjësisë profesionale ndaj palëve të treta, kundrejt dëmeve të shkaktuara nga kryerja e veprimtarisë së agjentit në një shumë jo më të vogël se 100,000 lekë për çdo ngjarje të siguruar, ose jo më të vogël se 150,000 lekë në vit për të gjitha rastet e sigurimit;
 - b. Dokumentin bankar që vërteton depozitimin në një llogari qëllimore të garancisë financiare, me përjashtim të subjektit bankë ose dega e bankës së huaj;
 - c. Kur subjekti financiar jobankë do ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime për Jetë dhe Jo-Jetë, depoziton dokumentin bankar që vërteton depozitimin në llogari të ndara qëllimore të garancisë financiare.

2. Agjenti i miratuar, i cili ka kontratë punësimi me një person juridik që ushtron veprimtarinë e agjentit në sigurime, nuk është i detyruar të ketë sigurim të përgjegjësive profesionale dhe garanci financiare. Këto detyrime janë të personit juridik.

KREU VI

TRANSFERIMI I PARAVE NGA KONSUMATORI TEK SHOQËRIA E SIGURIMIT DHE ANASJELLTAS

Neni 17

Rakordimi i agjentit me shoqërinë e sigurimit

1. Personi fizik dhe juridik i miratuar/licencuar për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, detyrohet:
 - a. Të mbajë inventarin e saktë të policave të sigurimit, të dhëna nga shoqëria e sigurimit, të ndara sipas klasave të sigurimit, kategorive dhe të dhënave të tjera identifikuese dhe ta paraqesë atë gjatë kontrollit të ushtruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
 - b. Të regjistrojë primet e arkëtuara në një libër të veçantë, ku pasqyrohen vleftat, primi, komisioni, data e kryerjes së pagesës, lloji i monedhës, mënyra e kryerjes së pagesës, nr. i serisë dhe data e lëshimit të policës, lloji i saj, i siguruari dhe shënime të tjera që mund të konsiderohen të rëndësishme;
 - c. Të arkëtojë primin përpara lëshimit të policës së sigurimit tek i siguruari. Arkëtimi i primit dokumentohet me mandat arkëtimi (kur pagesa bëhet me para në dorë) dhe me dokument bankar (kur pagesa bëhet nëpërmjet bankës). Mandati i arkëtitimit lëshohet në tre kopje, nga të cilët një i jepet klientit, një e mban agjenti dhe një dorëzohet çdo javë së bashku me policat e sigurimit në shoqërinë e sigurimit;
 - d. Të mbajë librin e shitjes së policave, sipas formularit të përgatitur dhe dorëzuar nga shoqëria e sigurimit, ose sipas formatit të përcaktuar nga Autoriteti për produktet e sigurimit që shiten në sistemin online;
 - e. Të bëjë rakordimin me shoqërinë e sigurimit, lidhur me policat e shitura në fund të çdo periudhe një javore, duke përpiluar proces verbalin përkatës, i cili duhet të përmbajë, numrin total të policave të tërhequra, të shitura, të anuluar ose të humbura apo të dëmtuara.

Neni 18

Transferimi i parave nga konsumatori tek shoqëria e sigurimit

1. Personi fizik dhe juridik, i miratuar/licencuar për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, duhet:

- a. Të përdorë, për transferimin e parave (primeve) nga konsumatori tek shoqëria e sigurimit, llogari bankare të veçanta për veprimtarinë e Jetës dhe Jo-Jetës, të hapura për këtë qëllim nga shoqëria e sigurimit, në një nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, llogari bankare mbi të cilat nuk ka asnjë të drejtë;
- b. Të depozitohet në këtë llogari primet e grumbulluara jo më vonë se një ditë pune. Për ditët e diela, festa dhe pushime, primet e grumbulluara depozitohen menjëherë në ditën pasardhëse të punës dhe dërgohen në shoqëri evidencat sipas urdhrave dhe udhëzimeve të shoqërisë së sigurimit;
- c. Të kontrollojë rregullisht derdhjen e primeve sipas afatit të përcaktuar në pikën b) të këtij neni dhe marrë masa për zgjidhjen e menjëhershme, kur ndodhin mospërputhje të derdhjeve në llogarinë e hapur nga shoqëria e sigurimit me ato që rezultojnë nga rakordimet me shoqërinë e sigurimit.

KREU VI TË FUNDIT

Neni 19 Dispozitë kalimtare

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të licencuar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, me përfundimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, duhet të aplikojnë për ushtrimin e veprimtarisë së agentit në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 20 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.